

SHP DIBËR DHE QENDËR ZHUPA



Petrit Imami, kryetar i ri i shoqatës

SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, për shkak të vdekjes së kryetarit Xhavit Karpuzi, i cili parak pak kohësh ndërroi jetë pas një sëmundje të shkurtë, mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, në të cilën u zgjedh kryetari i ri i shoqatës. Xhevad Karpuzi ishte zgjedhur për herë të dytë në funksionin si kryetar i SHP Dibër dhe Qendër Zhupa, ishte delegat në Kuvendin e LSHPM dhe anëtar i Bordit ekzekutiv të Lidhjes.

Në seancën e jashtëzakonshme, ku morën pjesë rreth 2 mijë pensionistë nga komunat Dibër dhe Qendra Zhupë, për kryetar të ri u zgjodh Petrit Imami, ekonomist, përderisa për delegat të Kuvendit të Lidhjes së shoqatës së pensionistëve të Maqedonisë u zgjodh Avni Ramadanoski.

Në Kuvendin në Dibër, siç informoi kryetari i ri, është bërë fjalë edhe për aktivitetet e metutjeshme të Bordit ekzekutiv dhe punën e komisioneve të shoqatës. Sipas Imamit, do të realizohen të gjitha aktivitetet e shtyra në Programin e punës për vitin 2020, si dhe aktivitetet e tjera në pajtim me Statutin e shoqatës.

Duhet të ceket që shoqata, e cila i mbulon aktivitetet e pensionistëve të komunave Dibër dhe Qendra Zhupë prej gjithsej rreth 2 mijë anëtarë rreth 1500 janë në komunën Dibër dhe diçka më shumë se 400 në komunën rurale Qendër Zhupa. Me qëllim të kenë kushte të mira edhe pensionistët e Qendër Zhupa, në objektin e vetëqeverisjes lokale për ta është hapur klubi i pensionistëve, ashtu siç ka për pensionistët dibran. *Vjollca Sadiku*

Prej 1 mars nuk del "Penzionerski vidici", ndërsa në gazetën "KOHA" edhe më tej del një faqe në gjuhën shqipe, por secila shoqatë merr faturë dhe e paguan vetë, jo si deri tani të u merret nga anëtarësia

Më 28 shkurt të këtij viti mbajt seanca e 7-të e Bordit ekzekutiv të LSHPM. Në seancë u sollën dhe shqyrtuan më shumë çështje dhe vendime në lidhje me punën dhe aktivitetet aktuale të Lidhjes, por e njëjta kryesisht ishte seancë përgatitore për seancën e ardhshme të Kuvendit të LSHPM. Krahas anëtarëve, në seancë morën pjesë edhe: kryetari i Kuvendit të LSHPM, m-r Ilija Adamoski, kryetari i Bordit mbikëqyrës Mitre Stojanovski, kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion Zdravko Petkovski dhe Petar Andreevski, llogaritari i LSHPM. Sipas praktikës së zakonshme, kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova i numëroi dhe shkurt i shpjegoi aktivitetet e Lidhjes mes dy seancave.

Për Propozim-raportin e punës së Lidhjes së shoqatës së pensionistëve të Maqedonisë për vitin 2019, fjalinë hyrëse e kishte kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova. "Në raport janë të dhëna të gjitha përmbajtjet për punën e realizuar gjatë një viti nga ana e kësaj përbërje të re. Është dhënë shpjegim dhe shqyrtim të të gjitha aktivitetëve të cilat ishin ndërmarrë në periudhën e kaluar njëvjeçare. Në pjesën e parë u shfa-

SHP ÇAIR

ANGAZHIM PËR SUKSESE MË TË MËDHA

Për punën e SHP Çair për vitin 2019, në mënyrë të gjerë dhe konstruktive u debatua në seancën e Kuvendit të kësaj shoqate, e cila u mbajt më 27 shkurt të këtij viti. Në seancë u shqyrtuan dhe miratuan Statuti i SHP Çair, Raporti vjetor për realizimin e qëllimeve dhe detyrave dhe aktivitetit, Llogaria përfundimtare për vitin 2019, Raporti i Komisionit mbikëqyrës, si dhe Programi për punë dhe Plani financiar për vitin 2020. Seancën e udhëhoqi kryetari i Kuvendit Rauf Hamidi, i cili në fillim potencoi që me punën me përgjegjësi dhe shpenzimin racional të mjeteve, të gjitha detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në vitin e kaluar janë realizuar me sukses.

Fjalën hyrëse për raportin vjetor e kishte koordinatori Todor Iliev. Ai e bëri një mesatare të të gjitha aktivitetëve të cilat ishin planifikuar dhe realizuar për vitin 2019. Pastaj

MIRATOHEN RAPORTET PËR PUNËN E LSHPM NË VITIN 2019



qën realizimet e aktivitetëve programore, pastaj u dhanë të dhëna statistikore për numrin e shfrytëzuesve të pensionit, pensioneve mesatare, orari i anëtarësisë, miratimet e pensioneve, u mbajtën revyja të këngës, muzikës dhe lojërave, garat sportive pensioniste dhe të tjera", është shprehur Trajkova.

Është ofruar mbështetje materiale për shoqatat e pensionistëve, të cilat janë nikoqir të revyve dhe garave sportive, të shoqatave që kanë organizuar takime të pensionistëve, si dhe shoqatave më të vogla të cilat hapnin klube për pensionistë dhe kanë kryer adaptim të klubeve dhe hapësirave të punës. Është përgatitur dhe Rregullorja për mbështetje materiale të shoqatave të pensionistëve, si dhe Rregullorja për veprimtari botuese dhe krijuese. Vend i veçantë në punë të Lidhjes në vitin 2019 i është kushtuar punës së organizatës së regjistruar për fond dhe anëtarësim solidar. Bëhet saktësimi i të dhënave

për anëtarët e shoqatës, me çka bëhet shifrimi i mbi 90 000 anëtarëve, të cilët të drejtën e pensionit e kanë realizuar prej 15 shkurtit të vitit 2015 deri më 30 qershor të vitit të kaluar, ndërsa për momentin punohet për shifrimin e anëtarësisë prej 1 korrikut deri më 31 dhjetor të vitit të kaluar.

Për Raportin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara për vitin 2019 të Lidhjes, shpjegim të shkurtë dha sekretarja Menka Temelkovska, e cila theksoi që në vitin e kaluar janë realizuar të ardhura në shumën prej 9.132.282 denarë. Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në shumën prej 7.567.982 denarë dhe të njëjtat janë më të ulëta në krahasim me ato të planifikuar dhe realizuar në vitin 2018, që do të thotë që është kursyer dhe në mënyrë racionale janë shfrytëzuar mjetet. Dy Raportet u miratuan njëzëri.

Në seancë u caktuan nikoqirët e revyve dhe garave sportive si dhe

bordet organizative.

Për Informacionin lidhur me rezultat nga Rregullorja për shpërgim të shoqatave të pensionistëve-anëtare të LSHPM, për llojet dhe format e informimit, fjalim dha edhe nënkryetari Mentor Qoku, i cili tha që pas analizës së realizuar të rezultateve, 29 shoqatat nuk duan të informohen përmes "Penzionerski vidici" ndërsa "për" u deklaruan 23 shoqata. Ndërsa në lidhje me gazetën "KOHA", prej 16 shoqatave të cilat marrin gazetën "KOHA", 11 duan të marrin, ndërsa 5 nuk duan. Informacioni u miratua me një votë kundër. Pastaj u sollën vendimet në vijim ku prej 1 mars nuk del "Penzionerski vidici", ndërsa në gazetën "KOHA" edhe më tej del një faqe në gjuhën shqipe, por secila shoqatë merr faturë dhe e paguan vetë, jo si deri tani të u merret nga anëtarësia. Gjithashtu, të lidhet marrëveshje me gazetën "KOHA". Në seancë u sollën edhe vendime të tjera. *KSA*



theksoi që në vitin e kaluar shoqata ka realizuar punën organizative më të madhe, më të gjerë dhe të suksesshme deri më tani, veçanërisht në realizimin e të drejtave të pensionistëve nga fusha e mbrojtjes pensionale dhe shëndetësore, në fushën kulturore-zbatuese dhe sportive, pushim dhe rekreacion, në ndarjen e ndihmës humanitare, ekskursioneve, si dhe në informimin, ku kanë qenë të përfshirë një numër i madh i pen-

sionistëve.

Për programin për vitin 2020, foli edhe kryetari i SHP Çair dhe nënkryetari i LSHPM Mentor Qoku, i cili theksoi që vend kryesor u epet çështjes sociale, rekreacionit të banjave dhe atyre klimatike dhe sportive, revyve e të tjera. Ai mes tjerash theksoi që reprezentues të ngjarjeve kulturore kuptohet që është korri dhe grupi i këndimit në gjuhën shqipe, me të cilin shoqata përfaqësohet në revytë rajonale

dhe republikane të këngës, muzikës dhe lojërave që i organizon LSHPM. Rëndësi u është dhënë edhe aktivitetëve të degëve dhe klubeve.

Me sukses u vlerësua edhe puna financiare. Të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në kuadër të vitit të planifikuar dhe afarist që ka përfunduar me bilanc pozitiv. Kryetari i Bordit mbikëqyrës Violeta Shishkova, i informoi të pranishmit që anëtarët e Bordit mbikëqyrës kanë konstatuar që puna financiare dhe materiale bëhet në pajtim me dispozitat ekzistuese ligjore, ndërsa mjetet janë harxhuar në pajtim me planin vjetor financiar, në mënyrë të kursyeshme, me përgjegjësi dhe rreptësisht të përkushtuar.

Në debat në lidhje me këto dokumente morën pjesë më shumë debutues, të cilët i shprehën mendimet dhe propozimet e tyre për përmirësimin dhe avancimin e punës së Shoqatës. *Vasil Paçemski*